



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit: 22.6.1-2010-08

**RAPORT I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË PEJËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2010**

Prishtinë, Qershor 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje.....	5
II. Opinioni i auditimit	7
III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....	7
IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar	8
V. Pasqyrat financiare	9
V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	9
V.2 Cilësia e informatave	9
VI. Realizimi i Buxhetit.....	10
VI.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)	10
VI.2 Shpenzimet.....	11
VI.3 Subvencionet dhe transferet	13
VI.4 Pasuritë dhe Borxhet	14
VII. Kontrolli mbi menaxhimin	16
VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	16
VII.2 Auditimi i Brendshëm.....	16
VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës.....	18
Shtojca I. Komentet e Komunës së Pejës dhe përgjigja e ZAP	19
Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioeneve të Auditimit.....	19

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
IRD	Internacional Relief and Development
KA	Komiteti i Auditimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
LAB	Ligji për Auditimin e Brendshëm
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007. Përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
UA	Udhëzim Administrativ
UNDP	Program i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZKA	Zyrtar Kryesor Administrativ

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Gjatë formulimit të opinionit ne vlerësuam mjaftueshmërinë e prezantimit të informacionit në pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe llogaritë e arkëtueshme nuk ishte i plotë dhe i saktë. Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse dhe llogarive të arkëtueshme nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendi të raportit, të cilat duhet të adresohen nga menaxhmenti për të përmirësuar performancën e organizatës.

Për PVF të vitit 2009 ishin dhënë pesë rekomandime. Prej tyre nuk ishte adresuar asnjë rekomandim.

Rekomandimi ynë kryesor është që Kryetari i komunës duhet të siguroj se janë zhvilluar udhëzime dhe procedura të qarta të cilat duhet të ndihmojnë adresimin e dobësive dhe mangësive të identifikuara në këtë raport.

Ne rekomandojmë që veçanërisht të siguroni:

- Adresesimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna për vitin 2009;
- Përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare në përputhje të plotë me UA;
- Harmonizimin e të gjitha të hyrave vetjake në baza të rregullta;
- Zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit në pajtim me LPP;
- Shpalosjen e të gjitha llogarive të arkëtueshme, sipas UA nr. 16/2010;
- Mbajtjen e regjistrave të saktë dhe të plotë të obligimeve të pa paguara nga Drejtoria e Financave si dhe shpalosjen e tyre; dhe
- Regjistrat e plotë për pasurinë e komunës.

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të bërë komente në draftin e këtij raporti. Menaxhmenti i Komunës i ka pranuar të gjeturat dhe konkludimet tona në raportin e auditimit për PVF për vitin 2010.

Menaxhmenti është zotuar që do t'i bëjë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës të përgatisë PVF sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA), nr. 16/2010 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë për Komunën e Pejës.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të Komunës së Pejës. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në PVF, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisive tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;

- Kemi përcaktuar nëse ato janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Komunë.

Në këtë raport, ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe do të japim një opinion formal mbi PVF të Komunës së Pejës për vitin 2010.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF të komunës, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 2.

II. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe llogaritë e arkëtueshme nuk ishte i plotë dhe i saktë. Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse dhe llogarive të arkëtueshme nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në raportin e auditimit të KPMG-së për PVF të vitit 2009, ishin dhënë pesë rekomandime kryesore. Prej këtyre rekomandimeve, asnjë rekomandim nuk ishte adresuar. Këto rekomandime ndërlidhen me:

- Përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në të gjitha informacionet relevante;
- Regjistrimin e plotë të pasurive fikse;
- Përmirësimin e sistemit të kontabilitetit, duke aplikuar një sistem automatik të faturimit;
- Regjistrimin e të gjitha faturave të papaguara; dhe
- Fuqizimin e auditimit të brendshëm si mjet parandalues të gabimeve.

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona, ka shkaktuar të njëjtat probleme si në vitet e kaluara. Shprehim shqetësimin tonë për të gjitha rekomandimet e pa implementuara.

IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Shpenzimeve në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve

Në euro (€)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar 2010	Buxheti i shpenzuar 2009
Granti i Qeverisë – Buxheti	11,901,808	12,244,700	12,499,812	12,479,354	10,887,000
Të hyrat vetjake	2,391,751	2,391,751 ¹	3,297,324 ²	2,484,255	3,112,000
Donacionet e vendit			38,445	15,228	
Donacionet e jashtme			942,189	610,005	580,000
I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve	14,293,559	14,636,451	16,777,770	15,588,842	14,579,000
Paga dhe mëditje	7,558,885	7,981,092	8,297,236	8,264,596	7,273,000
Mallra dhe shërbime	1,076,027	1,101,021	1,463,350	1,327,424	1,112,000
Shpenzimet komunale	495,412	496,810	506,809	505,753	493,000
Subvencionet dhe transferet	226,948	287,148	290,022	286,867	245,000
Investimet Kapitale	4,936,287	4,770,380	6,220,353	5,204,202	5,456,000
II. Gjithsej shpenzimet	14,293,559	14,636,451	16,777,770	15,588,842	14,579,000

Sipas të dhënave nga tabela më lartë, shihet se buxheti final për vitin 2010 për komunën e Pejës ka qenë 16,777,770€ Shpenzimet totale për vitin 2010 ishin 15,588,842€apo rreth 93% e buxhetit final. Buxheti i pa shpenzuar në fund të vitit 2010 ishte 1,188,928€apo 7%.

Buxheti final është më i lartë se buxheti i rishikuar për shkak se komuna gjatë vitit 2010 ka përfituar nga donacionet e brendshme një shumë prej 38,445€ si dhe nga donacionet e jashtme shumë prej 942,189€

Ndërsa buxheti final nga granti i qeverisë është më i lartë se sa buxheti i rishikuar për 255,112€ për shkak se MEF në fund vitit ka ndarë 215,112€për pagesën e shujtave dhe 40,000€për investime kapitale.

¹ Të hyrat e planifikuara

² Në këtë shumë janë përfshirë të hyrat vetjake të bartura nga viti 2009 në vlerë 765,624€dhe të hyrat e inkasuara për vitin 2010 prej 2,531,700€

Prej të hyrave nga donacionet e brendshme janë shpenzuar gjithsej 15,228€ Ato kryesisht ishin shpenzuar për investime kapitale, ndërsa nga donacionet e jashtme janë shpenzuar 493,790€ për investime kapitale dhe 116,215€ për mallra dhe shërbime.

Konkluzion

Menaxhmenti i komunës ka treguar një performancë buxhetore mjaftë efektive. Të dhënat me lartë paraqesin efektivitet në shfrytëzimin e buxhetit. Përkundër kësaj performance, konkludojmë se Komuna ende do të duhej të përpiqej që të siguroj ekzekutim të buxhetit me mirë të planifikuar.

V. Pasqyrat financiare

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat e LMFP nr. 03/L-048 dhe UA 16/2010, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- Komuna ka përgatitur PVF në pajtim të plotë me UA nr. 16/2010, përveç shpalosjeve të llogarive të arkëtueshme dhe pasurive;
- PVF të komunës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme;
- Ato janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Brenda kornizës kohore me datën 31/01/2011 dhe janë dorëzuar në MEF;
- PVF janë përgatit vetëm në gjuhën shqipe; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MEF-it gjatë vitit 2010.

Konkluzion

PVF janë përgatitur sipas UA me përjashtim mungesës së shpalosjeve të llogarive të arkëtueshme dhe pasurive si dhe përgatitja vetëm në një gjuhë.

V.2 Cilësia e informatave

PVF përmbanin këto mangësi:

- Në shënimin 27, Pasuritë jo financiare ishte prezantuar shuma prej 3,771,000€ e cila nuk është e saktë për shkak të mos regjistrimit të plotë të pasurisë fikse. Sipas

pohimeve të zyrta për regjistrimin e pasurisë kjo shumë nuk prezanton gjendjen faktike për shkak të mos regjistrimit të plotë të pasurisë fikse; dhe

- Në shënimin 28 nuk është regjistruar asnjë shumë për të arkëtueshmet.

Konkluzioni

Nga rishikimi i PVF-ve, ne konkludojmë se komuna nuk kishte arritur të prezantoj të gjitha informatat e kërkuara me UA Mungesa e prezantimit të të gjitha shënimeve të kërkuara ka si rezultat prezantimin jo të drejtë dhe të saktë të informatave financiare dhe jo financiare në PVF.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare të përfillen të gjitha kërkesat që dalin nga UA me qëllim që pasqyrat të prezantojnë drejtë pozitën financiare të komunës; dhe
- Përgatitjen e pasqyrave financiare nëntë mujore për vitin 2011.

VI. Realizimi i Buxhetit

VI.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Të hyrat vetjake të pranuar për vitin 2010 ishin 3,297,324€ Prej tyre, të hyrat vetjake të bartura nga viti 2009 ishin 765,624€, ndërsa të hyrat e mbledhura për vitin 2010 ishin në shumën prej 2,531,700€

Në vijim do të prezantohen gjetjet kryesore që kanë rezultuar nga testimet tona për kategorinë e të hyrave.

- Barazimi i të hyrave në mes drejtorive të cilat gjenerojnë të hyra dhe zyrtarit të të hyrave nuk është kryer në baza të rregullta kohore. Në veçanti nuk është kryer barazimi i të hyrave në mes drejtorisë për gjeodezi dhe kadastër dhe drejtorisë së financave. Shënimet e mbajtura në drejtorin për kadastër dhe gjeodezi nuk mbahen në formë elektronike, sepse zyrtarët në këtë zyre nuk kanë aftësi që të punojnë me kompjuter;
- Në drejtorinë e kadastrit kemi vërejtur se të hyrat nga taksa për matjen e tokës janë regjistruar në kodin e taksave tjera administrative;
- Te licencat e biznesit kemi vërejtur se komuna nuk ka zbatuar kamata ndëshkuese për vonesat në pagesën e licencave; dhe
- Nuk janë mbajtur shënime për debitorët, përkatësisht llogarive të arkëtueshmeve për asnjë kategori ekonomike të të hyrave.

Konkluzion

Mos barazimet e të hyrave nga komuna mund të ndikojnë në nënvlerësimin apo mbivlerësimin e të hyrave vetjake. Regjistri jo i plotë për të hyra ndikon që menaxhmenti të mos ketë pasqyrë të besueshme për gjendjen e të hyrave vetjake. Klasifikimi i të hyrave në kode ekonomike të gabuara, ofron një pasqyrë çorientuese për të hyrat sipas departamenteve. Dhe, mos mbajtja e regjistrave për debitorët, rrit rrezikun që obligimet kontraktuese të mos paguhen, p.sh: inkasimet nga qiraja, dhënia në koncesion e pronave publike, etj.

Rekomandim 2

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Harmonizimet e duhura mujore në mes të drejtorive dhe drejtorisë së financave ;
- Trajnime përkatëse për zyrtarët komunal që kanë vështirësi në punën me kompjuterë, ;
- Se të gjitha të hyrat janë regjistruar sipas kodeve përkatëse;
- Mbajtjen e plotë të regjistrave për të hyra vetjake; dhe
- Mbajtjen e regjistrave për llogarit e arkëtueshme.

VI.2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimit

Pagesat e kanë tejkalluar shumën e kontratës

Te kontrata “Furnizim me naftë për Qendrën kryesore të mjekësisë familjare” ishte paguar sasia prej 8,110 litra, ndërsa ishin pranuar 7,785 litra. Mesatarja e çmimit furnizues ishte 1.07€litër, ka pasur një mbi pagesë në shumë prej 348€

Te kontrata për “Servisimin e automjeteve” kemi gjetur se janë paguar shumë artikuj të cilët nuk gjinden në specifikacionin teknik të operatorit. Vlera e testuar ishte 8,948€ndërsa vlera e artikujve jashtë kontratës ishte 7,589€

Tek kontrata “Ndërtimi i shtëpive për të kthyerit dhe për raste sociale në kuadër të programit për kthimin e refugjateve në Kosovë” në vlerë të kontratës prej 53,547€ kemi gjetur se shuma totale e pagesave për këtë projekt ishte 131,284€ Shuma prej 77,737€ishte paguar më shumë se vlera e kontratës. Kjo kontratë ishte lidhur për ndërtimin e katër (4) shtëpive, ndërsa komuna kishte paguar dhe ndërtuar edhe shtatë (7) shtëpi më shumë. Sipas pohimeve të Komunës ky projekt është financuar nga United Nations Development Programme (UNDP) ndërsa komuna ka udhëhequr proceduat e prokurimit.

Gjithashtu zyrtarët komunal pohuan se lidhja e kontratës për katër shtëpi dhe pagesa për shtatë shtëpi pa kontratë ishte një gabim dhe në të ardhmen nuk do të përsëriten gabimet e tilla. Pra kemi të bëjë me një lëshim procedural. Pagesa e tretë është bërë vetëm me procesverbal të organit mbikëqyrës në shumë prej 51,284€ pa pranuar situacionin me përshkrim të punëve të kryera.

Lidhja e kontratës pa fonde të mjaftueshme dhe sigurim të vlefshëm të ekzekutimit

Te kontrata "Ndërtimi i rrugës nga OSBE deri te rrethi për Vitomiricë" në vlerë prej 1,779,785€ është nënshkruar kontrata pa siguruar fondet e mjaftueshme për këtë projekt. Ky sigurimi i ekzekutimit ishte kërkuar nga autoriteti kontraktues për një vit, ndërsa kompania fituese kishte ofruar vetëm për katër muaj.

Financime të projekteve pa mbikëqyrjen e duhur

Te projekti "Zgjerimi i rrjetit për furnizim me ujë në nëntë (9) fshatra" kemi vërejtur se komuna kishte transferuar 200,000€ direkt në llogarinë e International Relief and Development (IRD) . Përveç kësaj pagese, komuna nuk posedon asnjë raport apo dëshmi tjetër për nivelin e punimeve që janë kryer nga operatori. Bashkëfinancimi ka qenë 200,000€ nga komuna, 155,000€ nga IRD dhe 25,400€ nga kompania rajonale e ujit "Hidrodrini" Pejë. Komuna si financuese me pjesëmarrje më të lartë, nuk ka përcjellur punimet se a janë duke u realizuar sipas kushteve të kontratës dhe specifikacionit teknik.

Asnjë projekt nuk është kryer sipas planit dinamik

Te projekti "Ndërtimi i rrugës drejtimi Pejë - Deçan" me vlerë të kontratës 1,468,428€ ka pasur vonesa në realizimin e projektit. Raste të tilla ka pasur edhe në të gjitha projektet tjera të ekzaminuara.

Konkluzion

Rastet e mësipërme flasin për dështime serioze të sistemit të kontrollit. Komuna ka kontrolle të dobëta të prokurimit. Kontratat për projektet e kapitale nuk mbikëqyren mjaftueshëm nga komuna dhe për pasojë kemi pagesa të kryera jashtë kontratave, financime të pa kontrolluara dhe një numër parregullsish tjera. Të gjitha këto rrisin rrezikun se fondet e komunës mund të jenë shpenzuar jashtë kornizës ligjore, madje edhe të keqpërdoren.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Se të gjitha pagesat do të bëhen në pajtim me kushtet e kontratës;
- Se fondet e nevojshme janë siguruar para se të lidhen kontratat;
- Se organi mbikëqyrës i projekti kapital ka kompetencë dhe do të verifikoj me saktësi të gjitha sasitë dhe cilësinë e ndërtimeve. Për të gjitha devijimet nga projekti, do ta informoj me kohë investitorin; dhe
- Punët e kontraktuara do të kryhen sipas planit dinamik të paraparë me kontratë.

2.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2010 buxheti për paga dhe mëditje sipas Thesarit ishte 8,297,236€ ndërsa ishin shpenzuar 8,264,596€ apo 99,6%. Komuna kishte një shkallë mjaft efektive në planifikimin dhe shpenzimet për këtë kategori buxhetore. Në këtë fazë ne kemi testuar disa dosje të personelit, prej të cilave pesë raste të rekrutimeve në vitin 2010. Gjatë ekzaminimeve tona, nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi të rëndësishme për tu raportuar.

VI.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti për vitin 2010 për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ishte 290,022€ ndërsa shpenzimet ishin 286,867€ Gjatë testimit të disa mostrave për kategorinë subvencione dhe transfere, kemi vërejtur se komuna nuk kishte pasur politikë të brendshme përmes së cilës do të rregullohen kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen për një subvencion.

Në vijim do të prezantohen gjetjet kryesore që kanë rezultuar nga testimet tona:

- Në gjashtë (6) raste kemi vërejtur se kishte marrë vendime nga Bordi i Drejtorëve për subvencione para pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës. Në rastin e subvencionimit të klubit të xhudos, kërkesa ishte bërë më datën 15/06/2010, ndërsa vendimi më datën 21/05/2010. Klubit futbollistik "Besa" i ishte ndarë shuma prej 5,000€ sipas vendimit të datës 29/01/2010, ndërsa kërkesa ishte bërë më 04/02/2010. Raste të tilla të marrjës së vendimeve para kërkesës kishte edhe tek projekti "Pjesmarrja në panairin e librit, ditës së Pavarësisë, Ansamblin folklorik "Rugova" si për Teatrin e qytetit, për realizimin e një shfaqje;
- Në një rast kemi vërejtur se është marrë vendimi nga komuna për lejimin e mjeteve prej 8,000€ për Klubin e Xhudos "Ipon". Paratë nuk ishin transferuar në llogari të klubit, por në një llogari tjetër private të një personi të klubit;

- Në shumicën e rasteve të testuara nuk kemi gjetur se ekzistojnë dëshmi për rregullsinë e dhënies së subvencioneve përfituesve. Përfituesit nuk dorëzojnë raporte se mjetet e fituara janë shpenzuar në bazë të kërkesës dhe projekteve të ofruara.

Konkluzion

Komuna nuk ka kontrole të mira dhe politika të qarta mbi dhënien e subvencioneve. Miratimi i vendimeve nga bordi i drejtorëve për ndarjen e subvencioneve para pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave. Pastaj ndarja e tyre pa arsyeshmërinë e duhur të projekteve dhe mungesa e informatave kthyes/raporteve mbi shpenzimet, janë disa nga dobësitë që rrisin rrezikun se mjetet e ndara nga kategoria e subvencioneve nuk menaxhohen në mënyrën e duhur.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se bëhen analiza të plota me rastin e dhënieve të subvencioneve dhe të merren masa në rastet kur subvencionet nuk janë dhënë sipas kriterëve; dhe
- Të siguroj hartimin e një rregullore të brendshme që do të specifikonte qartë procedurat, kriteret dhe kontrollet mbi ndarjen e subvencioneve.

VI.4 Pasuritë dhe Borxhet

4.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Edhe në vitin 2010 komuna nuk ka arritur të bëjë vlerësimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë kapitale. Sipas regjistrimit kontabël, vlera e pasurisë fikse ishte regjistruar në shumë prej 3,842,312€

Kjo shumë kishte të bënte vetëm për pasurinë e regjistruar gjatë vitit 2010 dhe jo vlerën e bartur të të gjithë pasurisë. Komuna nuk ka arritur që bëjë regjistrimin e plotë të të gjitha objekteve afariste që shfrytëzohen, ndonëse këto objekte janë pronë komunale.

Konkluzioni

Bazuar në gjetjet tona konkludojmë komuna nuk kishte evidentuar në tërësi pasurinë e saj. Mos regjistrimi i plotë i pasurive kapitale mund të vije deri te keqpërdorimi i pasurisë komunale dhe e parandalon Komunën për të deklaruar drejtë pozitën financiare në fund të vitit.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Regjistrimin e plotë të pronës, objekteve dhe pajisjeve, në mënyrë që të këtë regjistrin përfundimtar për të gjitha pasuritë që ka nën posedim.

4.2 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pakryera e llogarive të pagueshme në fund të vitit 2010 ishte 566,000€ Këto obligime janë bartur për pagesë në vitin buxhetor 2011. Disa prej drejtorive kishin tejkualuar alokimet buxhetore, dhe për këtë arsye kishin mbetur obligime të pa paguara dhe ishin bartur si obligime për pagesë në vitin 2011.

Nuk ka evidenca të duhura për obligimet e bartura nga viti 2009

Komuna nuk ka mbajtur regjistra kontabël të cilët do të pasqyronin faturat e paguara gjatë vitit 2010 për shlyerjen e borxheve të bartura nga vitet paraprake. Burim kryesorë i informatave financiare në komunë është SIMFK. Komuna nuk ka një sistem të brendshëm të kontabilitetit i cili do të mundësonte informata të hollësishme për çdo llogari të pagueshme.

Konkluzioni

Mungesa e evidencave detaje për faturat e paguara rrit rrezikun se me rastin e pagesës nga komuna një faturë mund të paguhet më shumë se një herë.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Se departamenti i financave mban evidenca të plota dhe të sakta dhe bën regjistrimin e të gjitha faturave të paguara dhe të papaguara.

VII.Kontrolli mbi menaxhimin

VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Sfidat e përshkruara më lart tregojnë për dobësi në kontrollin e brendshëm të Komunës. Kjo tregon se nevojiten masa përmirësuese të kontrollit brenda komunës. Pikat më të dobëta të kontrolleve janë në regjistrimin, barazimin dhe postimin e të hyrave në kode të gabuara, devijimet nga rregullat e prokurimit, pagesat jashtë kontratave, monitorimi i pamjaftueshëm i projekteve dhe hyrja në kontrata pa sigurimin e fondeve. Mangësi substanciale vërehen edhe tek kontrollet financiare: çertifikimi i parregullt i pagesave dhe ndarja e subvencioneve pa kritere dhe procedura të qarta, mbetja e faturave të pa paguara dhe evidencat e pa qarta mbi obligimet e paguara nga vitet e kaluara.

Po ashtu, komuna nuk ka evidenca të sakta dhe të plota mbi pasuritë. Në kushte të tilla, edhe menaxhimi i pasurive nuk është e mundur të bëhet në mënyrën e duhur.

Konkluzion

Konkludimi ynë është se funksionimi i kontrolleve aktuale nuk ofron siguri se aktivitetet operative dhe administrative zhvillohen në pajtim të plotë me objektivat dhe përgjegjësitë e komunës.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se sistemi i kontrollit të brendshëm do të rishikohet dhe të propozohet marrja e masave të duhura për t'u siguruar se rivendosja e kontrolleve siguron eliminimin e të gjitha dobësive dhe mangësive të identifikuara me këtë raport.

VII.2 Auditimi i Brendshëm

Komuna e Pejës ka të organizuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm. Kjo njësi përbëhet nga dy auditorë dhe drejtori. NJAB kishte përgatitur planin strategjik dhe planin vjetor për vitin 2010. Për vitin 2010, NJAB kishte planifikuar të kryente nëntë (9) auditime, ndërsa kishte kompletuar tetë (8). Këto raporte të auditimit të bëra gjatë vitit 2010, kishin të bënin për periudhën 2009. NJAB nuk ka kryer auditime të transaksioneve për vitin 2010 si dhe nuk është vërejtur gatishmëri e komunës për zbatimin e rekomandimeve.

Po ashtu, ne kemi vërejtur se komuna ende nuk e kishte formuar komitetin e auditimit të brendshëm.

Konkluzion

Kryerja e auditimeve për periudhën 2009 nuk i shton shumë vlerë proceseve të cilat tashmë kanë përfunduar. Auditimi i brendshëm më tepër duhet të jetë i fokusuar në aktivitetet aktuale në mënyrë që të parandaloj gabimet dhe parregullsitë e organizatës. Injorimi i adresimit të rekomandimeve të auditimit tregon për një funksionim jo të mirëfilltë të auditimit të brendshëm.

Gjithashtu, mungesa e komitetit të auditimit ka refleksione në cilësinë dhe kontributet e NJAB.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Se NJAB do të kryej auditime periodike për periudhën brenda vitit vijues dhe se rekomandimet e dhëna do të adresohen në mënyrë meritore; dhe
- Se Komiteti i Auditimit të brendshëm do të formohet sa më parë i cili do të e siguronte implementimin e rekomandimeve të NJAB-së dhe ZAP-it.

VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës

Konkluzionet e përgjithshme

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se menaxhimi financiar dhe kontrollet e komunës përcillen me dobësi dhe mangësi të shumta. Gjetjet e mësipërme janë rezultat i dështimeve në disa fusha. Gjendja e paqartë me të hyrat, pagesat e pa qarta për projekte kapitale, hyrja në kontrata pa fonde të sigurta, janë vetëm disa nga sinjalet se menaxhmenti nuk ka nën kontrollë të plotë aktivitetet operative. Gjithashtu, kontrollet e dobëta vërehen edhe tek monitorimi i projekteve, vonesat në realizimin e tyre, e deri te pagesat pa kurrfarë kontrate, siç ka ndodhë rasti me ndërtimin e disa shtëpive, ku mbi 78,000€ishin paguar jashtë kontrate. Menaxhmenti i komunës nuk ka aplikuar mekanizma kontrolli/monitorimi as në dhënien e 200,000€në formë bashkëfinancimi për sigurimin e ujit për disa fshatra.

Dhe në fund fare, komuna nuk ka një pasqyrë të qartë dhe të kompletuar mbi pasuritë, pronat dhe pajisjet e saj. Nuk është bërë as vlerësimi e as inventarizimi vjetor i pasurive. Kjo flet për mundësinë që pasuritë e komunës mund të keqmenaxhohen, humben si dhe të abuzohet.

Nga sa u tha më lart, mendojmë se kontrollet e përgjithshme duhet substancialisht të forcohen dhe të përmirësohen.

Rekomandimi i Përgjithshëm

- Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që pas analizës së gjetjeve të raportit, të nxjerrë një pako masash dhe të obligoj të gjitha departamentet administrative të komunës të ndërmarrin veprimet e duhura për eliminimin e mangësive të identifikuara.

Shtojca I. Komentet e Komunës së Pejës dhe përgjigja e ZAP

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij Raporti. Menaxhmenti i Komunës ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në Raportin e auditimit mbi Pasqyrat Financiare për vitin 2010. Më tutje, ata janë zotuar se do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinion i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinion i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.